



DEPARTAMENTI I AKTEVE RREGULLATRE TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE  
Njësia e Programimit të Akteve Rregullatore dhe RIA  
Drejtoria RIA dhe e Konsultimit Publik

Tiranë, 13 maj 2026

**VLERËSIM**

Lënda: **Vlerësim i draft raportit të ndikimit rregulator (RIA) për projektligjin “Për tregjet e krypto-aseteve”.**

Vlerësimi i përgjithshëm: **90/100** Përgjithësisht pozitiv

**A) Informacione të përgjithshme mbi procesin**

Emërtimi i propozimit të politikës Projektligji “Për tregjet e kryptoaseteve”.

Ministria udhëheqëse MEI

Numri/data e RIAs 2026 – MEI – Nr.5

Statusi Finale

Data e marrjes për shqyrtim 6 mars 2026

Data e komenteve të fundit 13 maj 2026

Numri i komenteve të kryera/të reflektuara 28/27

Numri i ripunimeve 4

**B) Konteksti i politikës**

Qëllimi i kësaj nisme është vendosja e një kuadri gjithëpërfshirës ligjor për ushtrimin e veprimtarive të emetimit të krypto-aseteve dhe ofrimin e shërbimeve të lidhura me to, si dhe përafrimi i plotë me *acquis* e Bashkimit Evropian në fushën e financave digjitale, duke përmbushur kështu detyrimet e Shqipërisë në procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

**C) Vlerësimi i përgjithshëm**

Drejtoria vlerëson përpjekjet e Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit për të siguruar se ndërhyrja e qeverisë është e orientuar aty ku është e nevojshme, duke dhënë rezultate sa më të mira me një barrë dhe kosto minimale rregullatore dhe administrative.

*Për arsyet e lartpërmendura, Drejtoria vlerëson se raporti RIA, në versionin aktual, është përgjithësisht në përputhje me metodologjinë e vlerësimit të ndikimit. Institucioni ka evidentuar problemet duke shpjeguar shkaqet dhe efektet e tyre; grupet e prekura; arsyet e ndërhyrjes dhe lidhjen e nismës me objektivat e nivelit të lartë. Njëkohësisht, është kryer një analizë 2*

*mjaftueshmërisht cilësore dhe sasore mbi ndikimet e mundshme ekonomike/financiare dhe sociale, të opsionit të preferuar. Gjithashtu, çështjet që lidhen me zbatimin e opsionit të preferuar dhe monitorimin e ecurisë së arritjes së objektivave të vendosura janë trajtuar në një mënyrë përgjithësisht të detajuar.*

**D) Rekomandime për përmirësimin e mëtejshëm të RIAs**

Në vijim të gjetjeve të lartpërmendura, konsiderojmë se në mënyrë që RIA të jetë plotësisht në përputhje me kriteret e përcaktuara nga metodologjia, nga ana e strukturës hartuese duhet:

1. Të zhvillojë më tej analizën sasore mbi ndikimet e mundshme ekonomike/financiare, të opsionit të preferuar, mbi të gjitha grupet e prekura, duke plotësuar edhe shtojcat 2/a dhe 2/b të RIAs., sipas kërkesave të formatit dhe Metodologjisë së Vlerësimit të Ndikimit.